



THIRRJE PËR PROPOZIME

PROGRAMI "MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË GRAVE NË SHQIPËRI"

AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, në kuadër të programit trevjeçar 2019-2021 "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SIDA, shpall *Thirrjen e Parë për Propozime mbi 'Çështje për advokim lidhur me mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të grave në Shqipëri'*.

Me qëllim forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve advokuese e lobuese të AWEN dhe organizatave të saj anëtare për të drejtat e grave, duke mobilizuar më shumë aktorë, duke shfrytëzuar njohuritë, qasjet dhe përvojat tematike (sidomos në ndërhyrje monitoruese *watch-dog*), AWEN **do të japë fonde për nisma advokuese** që adresojnë çështje që kanë nevojë për vëmendje dhe ndërhyrje të menjëhershme.

Për këtë thirrje do të konsiderohen ndërhyrjet advokuese dhe monitoruese që adresojnë:

- *Mbështetje për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave vendorë të referimit për dhunën në familje;*
- *Mungesa e shërbimeve mbështetëse e të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës në bazë gjinore/dhunës në famije në nivel vendor;*
- *Zbatimi i Ligjit për Ndihmën Juridike të Garantuar në lidhje me aksesin në drejtësi të të mbijetuarve/ave nga dhuna më bazë gjinore/dhuna në familje - roli monitorues / watch dog për ndjekjen e zbatimit të ligjit dhe identifikimi dhe adresimi i boshllëqeve dhe sfidave;*
- *Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal;*
- *Fuqizimi ekonomik i grave, duke adresuar nevojën për ndërhyrje në nivel vendor për të fuqizuar vajzat dhe gratë vulnerabël;*
- *Të drejtat pronësore të grave, adresimi i pabarazive gjinore në të drejtat pronësore;*
- *Roli i medias në avancimin e të drejtave të njeriut të grave - përpjekje konkrete advokimi dhe lobimi që adresojnë disa çështje që lidhen me përfaqësimin dhe raportimin e çështjeve të të drejtave të vajzave dhe grave në mediat audiovizive;*
- *Ndërhyrje parandaluese parësore në nivel qendror dhe vendor që adresojnë dhunën në marrëdhëniet intime mes të rinjve adoleshentëve - duke përdorur rezultatet e studimit kërkimor të kryer nga AWEN gjatë vitit 2018. Ju mund ta shkarkoni studimin në linkun e mëposhtëm:*

<https://1drv.ms/b/s!AqP54sycddhugr9nk4-9V-vQJqjpHg>



- *Çështje të tjera relevante dhe urgjente që kanë nevojë të adresohen nëpërmjet ndërhyrjeve advokuese, që lidhen me grupet e vajzave e grave vulnerabël.*

Ndërkohë që synohet të ndikohen axhendat qendrore dhe vendore për çështjet e të drejtave të vajzave e grave, inkurajohet fuqimisht përfshirja e sa më shumë djemve dhe burrave (vendimmarrës, partnerë në ndërhyrje, profesionistë, të rinj, etj.) si partnerë të rëndësishëm ndryshimi dhe si pjesë e zgjidhjes.

Entitete që mund të aplikojnë:

- OJF-të që punojnë për çështje që adresojnë të drejtat e grave në Shqipëri;
- Grupime formale / të regjistruara të grave që punojnë në komunitete;
- Grupime joformale të grave që punojnë në komunitete dhe që aplikojnë në bashkëpunim me një OJF lokale të regjistruar që ka në fokus të drejtat e grave.

Madhësia e grantit: Grantet do të jenë në një minimum 2.000 EUR dhe maksimum prej 5.000 EUR.

Buxheti total i thirrjes është 25.000 EUR.

Koha e zbatimit të projekteve: Kohëzgjatja e projektit mund të jetë për një minimum prej 3 muaj deri në një maksimum prej 7 muajsh, duke filluar nga 15 Maj 2019 deri më 31 Dhjetor 2019.

Afati i fundit për aplikime: 30 Prill, 2019, ora 17.00.

Vlerësimi i projekteve:

Aplikantët do të vlerësohen lidhur me potencialin e projektit për të pasur një ndikim të prekshëm për të përmirësuar respektimin e të drejtave të vajzave e grave. Çdo projekt do të vlerësohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të përzgjedhjes:

1. Qasja Teknike: Rëndësia e nevojave dhe çështjeve të adresuara; Arsyetimi i nevojës së menjëhershme për ndërhyrje; Cilësia e aktiviteteve të propozuara; Logjika e ndërhyrjes së orientuar drejt rezultateve;
2. Kapacitetet organizative / e grupimit: Kapacitetet organizative dhe administrative; Përvoja relevante në tema të ngjashme;
3. Buxheti i Propozuar: Kosto dhe shpenzime të përshtatshme për ndërhyrjen;

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

- 1) Një projekt propozim i shkurtër sipas formatit bashkangjitur;
- 2) Propozim buxheti për t'u përdorur në mënyre efektive në linjë me qëllimet e projektit (aneks 1).



- 3) Dokumentacioni ligjor: Dokument regjistrimi në gjykatë i organizatës; Nipt; Ekstrakt bankar.
- 4) Në rastin e përfshirjes së një grupi joformal të grave, dokumentet shoqëruese duhet të përmbajnë prova të kompetencës dhe përvojës së mëparshme në ndërrhyrje të ngjashme.

Informacion:

Nëse aplikantët kanë pyetje në lidhje me aplikimin ose kanë nevojë për më shumë informacion mbi thirrjen për propozime, mund të kërkojnë informacion ose të kërkojnë një takim informues gjatë fazës së aplikimit. Na kontaktoni në: info@awenetwork.org dhe awencoordinator@hotmail.com;

Adresa ku duhet të dërgoni aplikimin:

Paketa e aplikimit që përfshin, projektin sipas formularit të bashkëngjitur të aplikimit, buxhetin dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të skanuara, duhet të dërgohet në info@awenetwork.org dhe awencoordinator@hotmail.com.

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj në anglisht – Nëse e keni të pamundur të përgatisni propozimin tuaj në anglisht, ju lutem dërgoni një kërkesë në adresën e emailit të AWEN (si më sipër).

Njoftimi për marrjen e aplikimeve do të jepet brenda 5 ditëve. Njoftimi lidhur me aprovimin apo refuzimin e propozimeve do të bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit. Të gjithë aplikantët do të njoftohen zyrtarisht me e-mail.